



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 26.07.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 23.07.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NNT" ALFA I për aktivitetin: "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" dhe me numër të prokurimit: **616 -18-362-121** nxjerr:

### V E N D I M

1. Pranohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "NNT ALFA I" e datës 23.07.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" me Nr.616 18 2602 521 Nr. Brendshëm 616 18 026 521 kundër *Vendimit për dhënje të kontratës* të AK –së, të datës .07.2018, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Anulohet Vendimi për dhënje të kontratës i publikuar me datë: 19.07.2018;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te aktivitetin ta kthej në rivlerësim*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "NNT ALFA I" me datë 23.07.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i parkut në lagjen Arbëria" me numër të prokurimit **616 18 2602 521** dhe numër të brendshëm **616 18 026 521**.

Autoriteti Kontraktues, me datë 25.07.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet për tenderuesin "Rexha SHPK":

1. Lidhur me pikën 1 pretendimi është i pa bazuar pasi që në CV-n emenaxherit janë shënuar disa projekte që i ka realizuar si menaxher dhe mbikqyrës i projektit dhe për këtë mund të kërkohej sqarime plotësuese nga tenderuesi;
2. Pretendimi i dytë është i pa bazuar, pasi që është kërkuar që eksperti të ketë diplomë të Fakultetit të Bujqësisë dhe nuk është cekur ndonjë drejtim specifik;

- 3.Pretendimet për pikat 3 dhe 4-inxhinierët e elektrikës me përvojë të njejtë nuk ka bazë,por për saktësim mund të kërkohet sqarimnga tenderuesi;
- 4.Pretendimi për mungesë të teknikut të ndërtimi është e pa qëndrueshme,pasiqë tendeuesi për këtë qëllim ka angazhuar inxhinierin Hilmi Mulaku,siqë shihet nga kontrata mbi vepër Neni 1;
- 5.Pretendimi për çmimin jo normalisht të ulët poashtu është i pa qëndrueshëm,pasiqë AK-ja ka zhvilluar një procedurë të sqarimit lidhur me këtë;
- 6.Pretendimi për certifikatë fitosanitare është pjesërisht i bazuar,pasiqë është dorëzuar një certifikatë e brendshme dhe nuk është verifikuar a i prodhon ato kompania e cekur apo i merr nga ndonjë vend tjetër;
7. Pretendimet lidhur me dozer dhe traktor poashtu jane te pa bazuara,pasiqe ekzistojne deshmitë per posedimin e tyre;dhe
- 8.Pretendimet për kapacitetet e eskavatorëve janë pjesërisht të bazuara,por për të verifikuar kapacitetet e sakta duhet të kërkohen dëshmi plotësuese nga tenderuesi i propozuar për dhënje të kontratës.

Bazuar në konstatimet paraprake konkludojmë se lidhur me pretendimet pjesërisht të bazuara duhet të kryhet një proces i rivlerësimit dhe në harmoni me nenin 72 të kërkohen sqarimet plotësuese për pikat e cekura dhe pastaj të verifikohet përgjegjshmëria e tenderëve të Oe-ik të cekur në kërkesë dhe në këtë Vendim.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

  
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit